

VENDIM
Nr. 273, datë 2.5.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1497, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar, pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Nga data 1 janar 2025 e në vijim, autorizohet shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a., për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale, sipas kuptimit në ligjin për akcizat në Republikën e Shqipërisë, kundrejt pagesës.

2. Ministria e Financave i kalon pa pagesë shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”, të gjitha të dhënat dhe aktivet, të marra në dorëzim nga koncesionari, sipas përcaktimeve të kontratës koncesionare “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të pullave fiskale”, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “*SICPA Security Solutions SA*” e “*SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.*”, të miratuar me ligjin nr. 10381, datë 24.2.2011, dhe të ndryshuar me ligjin nr. 17/2023.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku